



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**PROJEKT - VENDIM**

Nr.08, datë 09.11.2022

**PËR**

**KONFISKIMIN PËR INTERES PUBLIK TË TË SIPËRFAQES SË NDËRTUAR NË  
TEJKALIM TË LEJES SË NDËRTIMIT, PËR QËLLIM FITIMI, NË OBJEKTIN:  
“KOMPLEKS BANIMI DHE SHËRBIMESH 1 – 2 KAT, ME 1 KAT PARKIM NËNTOKË  
DHE ME MUR RRETHUES”, ME VENDNDODHJE NË SELITË, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të nënndarjes “iii” dhe “iv”, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, me propozim të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Konfiskimin për interes publik të sipërfaqes prej 1077.13 m<sup>2</sup>, të ndërtuar në tejkalim të lejes së ndërtimit, për qëllim fitimi, në objektin e miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr.E-14412/8, datë 03.08.2018 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “Kompleks banimi dhe shërbimesh 1 – 2 kat, me 1 kat parkim nëntokë dhe me mur rrethues”, me vendndodhje në Selitë, Bashkia Tiranë, me zhvillues shoqërinë “Aleksandros” sh.p.k.
2. Planvendosja e objektit të konfiskuar, bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Agjencia e Zhvillimit të Territorit të përcjellë këtë vendim pranë Ministrisë përgjegjëse në varësi të të cilës gjendet autoriteti përgjegjës për administrimin e pasurive të konfiskuara të shtetit.
4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ose autoriteti përfitues i konfiskimit të aplikojë nëpërmjet sistemit e-leje, për miratimin e një Leje Zhvillimi/Ndërtimi të re, si dhe lëshimin e Çertifikatës së Përdorimit, me qëllim rregullimin e pasojave të shkaktuara nga situata faktike, e krijuar nga ndërtimi në tejkalim të lejes së ndërtimit.
5. Pas miratimit të lejes përkatëse, Bashkia Tiranë të lëshojë certifikatën e përdorimit, në përputhje me këtë vendim dhe planvendosjen bashkëlidhur.

6. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kryejë regjistrimin e këtij vendimi, së bashku me certifikatën e përdorimit, sipas parashikimeve në VKM-në Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.
7. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

DRAFT

**MINISTËR I BRENDSHËM**

**BLEDAR ÇUÇI**

**ANËTAR**

**MINISTËR I FINANCEVE DHE EKONOMISË**

**DELINA IBRAHIMAJ**

**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**